



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2016

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Histori bërthamë

Varianti A

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	A	B	A	B	A	C	B	C	A	D

• *Pyetjet me zhvillim*

Pyetja 11 3 pikë

Model përgjigjeje

- Duke qenë se me përhapjen e reformatcionit, pozitat e kishës katolike u tronditën fort, Papati mendoi të mbledhte një koncil për të forcuar pozitat e kishës (për të rifituar besimtarët e humbur).
- Vetëm kisha mund të bënte shpjegimin dhe interpretimin e Biblës.
Shërbimet fetare të kryeshin në latinisht.
Priftërinjtë nuk mund të martoheshin.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse përcakton qëllimin e koncilit dhe dy nga vendimet;

OSE

2 pikë Nëse përcakton qëllimin e koncilit dhe një nga vendimet;

1 pikë Nëse përcakton qëllimin e koncilit OSE një nga vendimet;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12**3 pikë****Model përgjigjeje**

Pa pëlqimin dhe miratimin e parlamentit, mbreti:

- nuk mund të hartonte ose të shfuqizonte ligje.
- nuk mund të vendoste taksa.
- nuk mund të rriste numrin e ushtrisë në kohë paqeje.
- nuk mund të ndërhynte në diskutimet e anëtarëve të parlamentit.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse shkruan tri nga vendimet e mësipërme;
OSE
2 pikë Nëse shkruan dy nga vendimet e mësipërme;
1 pikë Nëse shkruan një nga vendimet e mësipërme;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13**3 pikë****Model përgjigjeje**

- Kriza e superprodimit. Rritja e prodhimit nuk eci në përpjestim të drejtë me fuqinë blerëse të konsumatorëve kjo çoi në mbiprodhim dhe shumë prodhime mbeteshin stoqe të pashitura.
- Shpërndarja e pabarabartë e pasurisë e cila ndikoi negativisht në nivelin e konsumit.
- U rrit shumë numri i kredive të pakthyera gjë që solli falimentimin e shumë bankave.
- Mos kryerja siç duhet e rolit rregullues dhe kontrollues të shtetit në ekonomi.
- Ligjet ndaluese shkaktuan zhvillimin e aktiviteteve kontrabandiste.
- Rënia e Bursës së New-Jorkut. Spekulumet në Bursën e New Jorkut tronditën sistemin financiar nëpërmjet rritjes artificiale të vlerës së aksioneve.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse identifikon tri nga shkaqet e krizës;
OSE
2 pikë Nëse identifikon dy nga shkaqet e krizës;
1 pikë Nëse identifikon një nga shkaqet e krizës;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14**3 pikë****Model përgjigjeje**

Me prishjen e marrëdhënieve me BS dhe vendeve të tjera socialiste, Shqipëria kishte nevojë për aleatë politikë.

- Nevoja e Shqipërisë për ndihma ekonomike, kredi, pajisje teknike dhe specialistë.
- Nevoja e Shqipërisë për ndihma ushtarake.
- RPK ishte larg dhe nuk mund të shprehte ndonjë kërcënim për pavarësinë e Shqipërisë apo rrëzimin e pushtetit etj.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse jep tre nga arsyet e vendosjes së marrëdhënieve të ngushta me RPK;
OSE
2 pikë Nëse jep dy nga arsyet e vendosjes së marrëdhënieve të ngushta me RPK;
1 pikë Nëse jep një nga arsyet e vendosjes së marrëdhënieve të ngushta me RPK;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare;

Pyetja 15 **2 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Përbënte një akt njohjeje kolektive të shtetit dhe qeverisë shqiptare.
- b) Ndikoi në marrjen e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Paris.

Nxënësi fiton:

- 2 pikë** Nëse shkruan dy nga të mësipërmet;
OSE
1 pikë Nëse shkruan një nga të mësipërmet;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare;

Pyetja 16 **3 pikë****Model përgjigjeje**

Reformat e ndërmarra me synimin për të përmirësuar sistemin nxorren në pah dobësi të mëdha në të gjitha fushat.

- Administrimi i trashëguar nga e kaluara nuk mund të përshtatej me kërkesat e ekonomisë së tregut.
- Teknikat e prodhimit ishin të prapambetura. Kjo çoi në rënie të vazhdueshme të prodhimit dhe mungesën e mallrave të konsumit në treg.
- Të gjitha shtresat e shoqërisë e patën të vështirë përshtatjen me filozofinë e ekonomisë së tregut.
- Reformat hasën në kundërshtime me forcat konservatore dhe radikale.
- Në të gjithë territorin e Bashkimit Sovjetik, u rishfaqën lëvizjet kombëtare të kombësive jo ruse. Kulmi arriti me kërkesat për pavarësi.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse jep tri nga arsyet e mosfunksionimit të reformave;
OSE
2 pikë Nëse jep dy nga arsyet e mosfunksionimit të reformave;
1 pikë Nëse jep një nga arsyet e mosfunksionimit të reformave;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 17 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- ishte kryetar i qeverisë;
- kontrollonte të tre pushtetet;
- emëronte dhe shkarkonte ministrat;
- kishte të drejtën e vetos pa apel;
- shpërndante parlamentin;
- të drejtën e shpalljes së zgjedhjeve;
- emëronte dhe shkarkonte të gjithë oficerët e lartë;
- ishte Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura etj.

Nxënësi fiton:

- 3 pikë** Nëse liston tri nga kompetencat;
OSE
2 pikë Nëse liston dy nga kompetencat;
1 pikë Nëse liston një nga kompetencat;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 18 **3 pikë****Model përgjigjeje****Përgjigje:**

- Për shkak të konsiderimit të qeverisë së Vlorës si një qeveri lokale nga Fuqitë e Mëdha.
- Veprimtaria e dy pushteteve të tjera në vend: Komisionit Ndërkombëtar në Shkodër dhe “Pleqësinë e Shqipërisë së Mesme” pënguan veprimtarinë kombëtare të “Qeverisë së Përkohshme të Vlorës”.
- Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit nuk e njohu qeverinë e Vlorës.
- Për shkak të zgjedhjes së një princi të huaj që së shpejti do të mbërrinte në Shqipëri, qeveria e të cilit do të njihej nga Fuqitë e Mëdha.
- Për shkak të mosrealizimit të objektivave që i vuri vetes në programin e saj si në aspektin e brendshëm, ashtu edhe në atë të jashtëm.
- Për shkak të mungesës së fondeve.

Nxënësi fiton:

3 pikë Nëse jep tri nga arsyet e mësipërme;

OSE

2 pikë Nëse jep dy nga arsyet e mësipërme;

1 pikë Nëse jep një nga arsyet e mësipërme;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 19 **4 pikë****Model përgjigjeje**

- Ndërtimi i Murit të Berlinit.
- Kriza e Kubës.
- Përfshirja e SHBA-së dhe BS në konfliktin e Vietnamit
- Përfshirja e SHBA-së dhe BS në konfliktin e Koresë.
- Përfshirja e SHBA-së dhe BS në Luftën Civile në Greqi.

Nxënësi fiton:

4 pikë Nëse jep katër nga të mësipërmet;

OSE

3 pikë Nëse jep tri nga të mësipërmet;

2 pikë Nëse jep dy nga të mësipërmet;

1 pikë Nëse jep një nga të mësipërmet;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 20 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- a) Vendimi i 29 korrikut 1913 është akti themelor i njohjes në arenën ndërkombëtare Pavarësisë së Shqipërisë.
- b) Nga njëra anë njihet Pavarësia e Shqipërisë e në anën tjetër parashikohet një kufizim i sovranitetit të shtetit në trajtën e një kontrolli ndërkombëtar (KNK).
- c) Gjysma e trojeve etnike shqiptare mbeten jashtë kufijve të shtetit.

3 pikë Nëse përgjigjja e nxënësit fokusohet në tre nga pikat e mësipërme;

OSE

2 pikë Nëse përgjigjja e nxënësit fokusohet në dy nga pikat e mësipërme;

1 pikë Nëse përgjigjja e nxënësit fokusohet në një nga pikat e mësipërme;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.